LIGJ
Nr. 83/2020

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E NDRYSHUAR TË ORGANIZATËS EVROPIANE TË TELEKOMUNIKACIONEVE SATELITORE (EUTELSAT)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e ndryshuar të Organizatës Evropiane të Telekomunikacioneve Satelitore (EUTELSAT), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.7.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11539, datë 9.7.2020, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

ORGANIZATA EVROPIANE
E TELEKOMUNIKACIONEVE SATELITORE

KONVENTA E NDRYSHUAR

SHËNIM REDAKSIONAL

Amendimet e Konventës origjinale, që krijojnë këtë Konventë të ndryshuar, janë miratuar nga Asambleja e Palëve të EUTELSAT-it në maj të vitit 1999. Ato janë zbatuar mbi një bazë të përshpejtuar (të përkohshme) që nga data 2 korrik 2001, në përputhje me një rezolutë për këtë qëllim, miratuar nga Asambleja e Palëve të EUTELSAT-it edhe në maj 1999.

Hyrë në fuqi, në mënyrë përfundimtare, më 28 nëntor 2002.

TABELA E LËNDËS

Hyrja

Neni I	Përkufizimet
Neni II	Krijimi i EUTELSAT-it dhe Kompanisë Eutelsat S.A.
Neni III	Qëllimet e EUTELSAT-it
Neni IV	Personaliteti juridik
Neni V	Kostot
Neni VI	Struktura e EUTELSAT-it

Neni VII Asambleja e Palëve – Përbërja dhe mbledhjet
Neni VIII Asambleja e Palëve – Procedura
Neni IX Asambleja e Palëve – Funksionet
Neni X Sekretariati
Neni XI Të drejtat dhe detyrimet
Neni XII Selia e EUTELSAT-it, privilegjet, imunitetet, përjashtimet
Neni XIII Tërheqja
Neni XIV Ndryshimet dhe përfundimi
Neni XV Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
Neni XVI Nënshkrimi – Rezervat
Neni XVII Hyrja në fuqi
Neni XVIII Aderimi
Neni XIX Përgjegjësia
Neni XX Dispozitat e ndryshme
Neni XXI Depozituesi
Aneksi A Dispozitat kalimtare
Aneksi B Procedura e arbitrazhit

HYRJE

Shtetet Palë në këtë Konventë,

duke theksuar rëndësinë e telekomunikacionit, me anë të satelitit për zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet popujve dhe ekonomive të tyre, dhe dëshirën e tyre për të forcuar bashkëpunimin në këtë fushë;

duke vërejtur se Organizata e përkohshme për Telekomunikacionin Satelitor Evropian "INTERIM EUTELSAT" është krijuar me qëllim për të operuar në segmentin hapësinor të sistemeve evropiane të telekomunikacionit satelitor;

duke marrë në konsideratë dispozitat përkatëse të Traktatit mbi Parimet që rregullojnë aktivitetet e shteteve në eksplorimin dhe shfrytëzimin e hapësirës kozmike, përfshirë Hënën dhe trupat e tjerë qiellorë, përfunduar në Londër, Moskë dhe Uashington, më 27 janar 1967;

duke dëshiruar vazhdimin e krijimit dhe operimit të sistemit të telekomunikacionit satelitor EUTELSAT, si pjesë e një rrjeti transevropian të telekomunikacionit, për të siguruar shërbime telekomunikacioni për të gjitha shtetet pjesëmarrëse, pa cenuar të drejtat dhe detyrimet e shteteve Palë në marrëveshjet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe në marrëveshjet e tjera ndërkombëtare;

duke dëshiruar vazhdimin e krijimit dhe të operimit të sistemit satelitor të telekomunikacioneve EUTELSAT, si pjesë e rrjetit të telekomunikacioneve transevropiane për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacioneve për të gjitha shtetet pjesëmarrëse, pa cenuar të drejtat dhe detyrimet e shteteve Palë në marrëveshjet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare;

duke njohur nevojën për të mbajtur nën shqyrtim dhe, sipas nevojës, për t'iu përshtatur zhvillimeve teknike, ekonomike, rregullatore dhe politike në Evropë dhe në botë, dhe, në veçanti, vullnetin për të transferuar veprimtaritë operative dhe asetet shoqëruese të EUTELSAT-it në një kompani me përgjegjësi të kufizuara, të themeluar nën një juridiksion kombëtar, kompani të tilla për të vepruar mbi baza të qëndrueshme financiare dhe ekonomike, duke pasur në vëmendje parimet e pranuara tregtare dhe Marrëveshjen,

bien dakord si më poshtë:

Neni I
Përkufizime

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) "Konventë" do të thotë Konventa për krijimin e Organizatës Evropiane të Telekomunikacioneve Satelitore "EUTELSAT", përfshirë hyrjen dhe anekset e saj, e hapur për nënshkrim nga qeveritë në Paris, më 15 korrik 1982, e amenduar më pas;

b) "Marrëveshje e përkohshme" do të thotë marrëveshja mbi themelimin e një organizate të përkohshme evropiane të telekomunikacionit satelitor "INTERIM EUTELSAT", përfunduar në Paris, më 13 maj 1977, ndërmjet administratave apo agjencive të njohura operuese private dhe e depozituar pranë administratës franceze;

c) "ECS marrëveshja" nënkupton marrëveshjen plotësuese të marrëveshjes së përkohshme në lidhje me segmentin hapësinor të Sistemit të Telekomunikacionit Satelitor për Shërbimin Fiks (ECS), përfunduar në Paris, më 10 mars 1978;

d) "Palë" nënkupton një shtet, për të cilën Konventa ka hyrë në fuqi ose ka qenë përkohësisht e zbatueshme;

d) "Drejtor i përgjithshëm i EUTELSAT-it" do të thotë kreu i organit ekzekutiv të EUTELSAT-it;

f) "Sekretari Ekzekutiv i EUTELSAT-it" do të thotë kreu i Sekretariatit të EUTELSAT;

g) "Kompania Eutelsat S.A." nënkupton një ndërmarrje, korporatë, e themeluar sipas ligjeve të njërës prej Palëve; ajo fillimisht do të jetë e vendosur në Francë;

h) "Segment hapësinor" nënkupton një grup satelitësh të telekomunikacionit dhe ndjekja, telemeteringu, komandimi, kontrolli, monitorimi, shërbimet e lidhura dhe pajisjet për mbështetjen operative të këtyre satelitëve;

i) "Sistemi satelitor" nënkupton njësinë e formuar nga një segment hapësinor dhe stacionet tokësore, duke pasur akses në këtë segment hapësirë;

j) "Telekomunikacion" nënkupton çdo transmetim, emetim ose marrje të shenjave, sinjaleve, shkrimeve, imazheve dhe tingujve ose inteligjenca e çfarëdo natyre, nga sistemet kabllore, radio, optike ose sisteme të tjera elektromagnetike;

k) "Parimet Themelore" nënkupton parimet e përmendura në nenin III, germa "a" e Konventës;

l) "Marrëveshje" do të thotë marrëveshja ndërmjet EUTELSAT-it dhe Kompanisë Eutelsat S.A., duke pasur si qëllim të saj, përcaktimin e marrëdhënies ndërmjet EUTELSAT-it dhe Kompanisë Eutelsat S.A. dhe detyrimet e tyre përkatëse, në veçanti për të siguruar kuadrin që do të mundësojë EUTELSAT-in të mbikëqyrë dhe të sigurojë respektimin nga Kompania Eutelsat S.A. të Parimeve Themelore.

Neni II
Krijimi i EUTELSAT-it dhe i Kompanisë Eutelsat S.A.

a) Nëpërmjet kësaj Konvente, Palët formojnë Organizatën Evropiane të Telekomunikacioneve Satelitore, e quajtur më poshtë "EUTELSAT".

b) i. Kompania Eutelsat S.A. do të krijohet për të operuar një sistem satelitor dhe për të ofruar shërbime satelitore dhe, për këtë qëllim, asetet e EUTELSAT-it dhe aktivitetet operacionale do t'i transferohen Kompanisë Eutelsat S.A.

ii. Kompania Eutelsat S.A. do të funksionojë nëpërmjet instrumenteve kushtetuese të saj dhe nga ligjet e vendit ku do të jetë regjistruar.

iii. Çdo Palë, në territorin e të cilit janë vendosur selitë e kompanisë Eutelsat S.A. ose në të cilin janë vendosur dhe/ose operojnë asetet, në përputhje me marrëveshjet e bëra ndërmjet Palëve dhe Kompanisë Eutelsat S.A., duhet të marrë masat e nevojshme për të lehtësuar krijimin dhe funksionimin e kompanisë Eutelsat S.A.

c) Marrëdhëniet ndërmjet EUTELSAT-it dhe Kompanisë Eutelsat S.A. do të përcaktohen në këtë marrëveshje.

d) Dispozitat përkatëse të aneksit A të Konventës do të zbatohen për qëllime të vazhdimësisë midis aktiviteteve të EUTELSAT-it dhe atyre të Kompanisë Eutelsat S.A.

Neni III

Qëllimet e EUTELSAT

a) Qëllimi kryesor i EUTELSAT-it është të garantojë që Parimet Themelore të përcaktuara në këtë nen të respektohen nga Kompania Eutelsat S.A. dhe, konkretisht:

i. Detyrimet për shërbimin publik/shërbimin universal: detyrime të tilla zbatohen për segmentin e hapësirës dhe për përdorimin e saj për të ofruar shërbime për rrjetin publik telefonik të komutuar; shërbimet audiovizuale dhe shërbimet e së ardhmes do të sigurohen në përputhje me rregulloret përkatëse kombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare, në veçanti, dispozitat e Konventës Evropiane për Televizionin Ndërkufitar, duke marrë parasysh ato që zbatohen në konceptin e shërbimit universal dhe shoqërinë e informacionit;

ii. Mbulimi panevropian nga sistemi satelitor: Kompania Eutelsat S.A. duhet, mbi baza ekonomike, të kërkojë që nëpërmjet mbulimit panevropian të sistemit të saj satelitor t'u shërbejë të gjitha zonave ku është e nevojshme, për shërbimet e komunikimit në shtetet anëtare;

iii. Mosdiskriminimi: shërbimet do të ofrohen për përdoruesit në mënyrë të barabartë, duke pranuar fleksibilitet/tolerancë tregtare dhe në përputhje me ligjet e zbatueshme;

iv. Konkurrencë e ndershme: Kompania Eutelsat S.A. duhet të jetë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme që lidhen me konkurrencën e ndershme.

b) EUTELSAT-i, gjithashtu, duhet të ketë qëllim të sigurojë vazhdimësinë, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet, sipas ligjit ndërkombëtar, në veçanti sipas radiorregulloreve për përdorimin e frekuencave që rrjedhin nga përdorimi i segmentit hapësinor të EUTELSAT-it, që i janë transferuar Kompanisë Eutelsat S.A.

Neni IV

Personaliteti juridik

a) EUTELSAT-i ka personalitet juridik.

b) EUTELSAT-i do të gëzojë zotësi të plotë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj dhe për arritjen e qëllimeve të saj dhe, në veçanti mund të:

i. të lidhë kontrata;

ii. të blejë, të marrë/japë me qira, të zotërojë dhe të disponojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme;

iii. të marrë pjesë si Palë në gjykim;

iv. të lidhë marrëveshje me shtetet ose organizatat ndërkombëtare.

Neni V

Kostot

a) Marrëveshjet do të lidhen ndërmjet EUTELSAT-it dhe Kompanisë Eutelsat S.A. për të mbuluar kostot dhe shpenzimet e EUTELSAT-it, sipas Marrëveshjes.

b) Kostot e shkaktuara për themelimin dhe funksionimin e Sekretariatit, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në marrjen me qira dhe kostot e lidhura me të, mbajtjen e zyrave, pagat dhe shpërblimet e stafit, kostot e organizimit dhe të zhvillimit të mbledhjeve të Asamblesë së Palëve, kostot e konsultimit ndërmjet EUTELSAT dhe Palëve, dhe organizimeve të tjera, si dhe kostot për zbatimin e masave të marra nga EUTELSAT, sipas nenit III, për të garantuar që Parimet Themelore janë respektuar nga Kompania Eutelsat S.A., do të përballohen nga Kompania Eutelsat S.A., në përputhje me paragrafin "a", të nenit V, brenda kufijve përkatës të përcaktuar në Marrëveshje.

Neni VI

Struktura e EUTELSAT-it

a) EUTELSAT-i do të ketë organet e mëposhtme:
i. Asambleja e Palëve;
ii. Sekretariati, i kryesuar nga Sekretari Ekzekutiv.
b) Çdo organ do të veprojë brenda kufijve të kompetencave që janë akorduar nga Konventa.

Neni VII
Asambleja e Palëve – Përbërja dhe mbledhjet

a) Asambleja e Palëve do të jetë e përbërë nga të gjitha Palët.
b) Një Palë mund të përfaqësohet nga një Palë tjetër në një mbledhje të Asamblesë së Palëve, por asnjë palë nuk mund të përfaqësojë më shumë se dy palë të tjera.
c) Mbledhja e parë e zakonshme e Asamblesë së Palëve do të zhvillohet brenda një viti pas datës në të cilën Konventa hyn në fuqi. Mbledhjet e zakonshme pas kësaj do të mbahen çdo dy vjet, përveç rasteve kur Asambleja e Palëve vendos në një mbledhje të zakonshme se mbledhja pasuese do të mbahet në një interval të ndryshëm.
d) Asambleja e Palëve, gjithashtu, mund të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme me kërkesë të një apo më shumë Palëve, mbështetur nga të paktën një e treta e Palëve ose me kërkesë të Kompanisë Eutelsat S.A. Një kërkesë e tillë do të përcaktojë qëllimin e takimit.
d) Çdo Palë do të mbulojë shpenzimet e veta të përfaqësimit në mbledhjet e Asamblesë së Palëve.

Neni VIII
Asambleja e Palëve – Procedura

a) Çdo Palë do të ketë një votë në Asamblenë e Palëve. Palët që abstenojnë nga votimi do të konsiderohet si mosvotuese.
b) Vendimet mbi çështjet thelbësore, duhet të merren me votë konfirmuese nga të paktën dy të tretat e palëve të pranishme ose atyre që përfaqësojnë dhe votojnë. Një Palë e cila përfaqëson një ose dy Palë të tjera, siç parashikohet në paragrafin "b", të nenit VII të Konventës mund të votojë veçmas për secilën Palë të cilën përfaqëson.
c) Vendimet për çështje procedurale do të merren nga një votë konfirmuese nga një shumicë e thjeshtë e Palëve të pranishme dhe që votojnë, secila ka një votë.
d) Kuorumi për çdo mbledhje të Asamblesë së Palëve do të përbëhet nga përfaqësuesit e një shumice të thjeshtë të të gjitha Palëve, nëse jo më pak se një e treta e të gjitha Palëve janë të pranishme.
e) Asambleja e Palëve do të miratojë rregullat e veta të procedurës, të cilat do të jenë në përputhje me dispozitat e Konventës dhe, në veçanti, do të përfshijnë dispozita, për:
i. zgjedhjen e kryetarit të tij dhe të zyrtarëve të tjerë;
ii. mbajtjen e mbledhjeve;
iii. përfaqësimin dhe akreditimin;
iv. procedurat e votimit.

Neni IX
Asambleja e Palëve – Funksionet

Asambleja e Palëve do të ketë funksionet e mëposhtme:

a) të ketë në konsideratë dhe të kontrollojë aktivitetet e Kompanisë Eutelsat S.A., që lidhen me Parimet Themelore. Kompania Eutelsat S.A. mund të bëjë rekomandime në lidhje me këtë, të cilat do të shqyrtohen nga ana e Asamblesë së Palëve;

b) të sigurojë respektimin nga Kompania Eutelsat S.A., të Parimeve Themelore, në përputhje me rregulloren;

c) të marrë vendime mbi ndryshimet e propozuara në rregullore, këto ndryshime të jenë subjekt i marrëveshjes së përbashkët të Palëve në rregullore;

d) të marrë vendimet e duhura, në mënyrë që të sigurojë vazhdimësinë, për sa u përket të drejtave dhe detyrimeve sipas ligjit ndërkombëtar, në veçanti bazuar në radiorregulloret për përdorimin e frekuencave, që rrjedhin nga përdorimi i segmentit hapësinor EUTELSAT, transferuar Kompanisë Eutelsat S.A.;

e) të marrë vendime mbi marrëdhëniet formale midis EUTELSAT-it dhe shteteve, qofshin Palë ose jo apo organizatat ndërkombëtare dhe, në veçanti, për të negociuar marrëveshjen për selinë qendrore, siç parashikohet në paragrafin "c", të nenit XII të Konventës;

f) të marrë vendime për çdo propozim për përfundimin e Konventës, në zbatim të paragrafit "c", të nenit XIV;

g) të marrë në konsideratë ankesat e parashtruara për të, nga Palët;

h) të marrë vendime bazuar në nenin XIII të Konventës, në lidhje me tërheqjen e një Pale nga EUTELSAT-i;

i) të vendosë mbi çdo propozim për amendimin e Konventës, bazuar në nenin XIV të Konventës dhe të paraqesë te Kompania Eutelsat S.A. çdo amendim të propozuar që ndikon në përmbushjen e aktiviteteve të saj;

j) të vendosë mbi çfarëdo kërkese, për anëtarësim, të bërë në përputhje me paragrafin "e", të nenit XVIII, të Konventës;

k) siç kërkohet, në bazë të nenit X të kësaj Konvente, për të vendosur mbi emërimin dhe largimin nga detyra të Sekretarit Ekzekutiv, dhe mbi rekomandimin e Sekretarit Ekzekutiv, të përcaktojë numrin, statusin, termat dhe kushtet e punësimit për të gjithë stafin e Sekretariatit, duke marrë në konsideratë Marrëveshjen;

l) të caktojë një zyrtar të lartë të Sekretariatit për të shërbyer si Sekretar Ekzekutiv në detyrë, kurdoherë që Sekretari Ekzekutiv mungon, është i paaftë të kryejë detyrat e postit të Sekretarit Ekzekutiv ose nëse ky post bëhet vakant;

m) të miratojë një buxhet vjetor ose dyvjeçar;

n) të miratojë ndryshimet për vendndodhjen e Kompanisë Eutelsat S.A., në përputhje me marrëveshjen.

Neni X
Sekretariati

a) Sekretariati do të drejtohet nga Sekretari Ekzekutiv i emëruar nga Asambleja e Palëve.

b) Mandati i Sekretarit Ekzekutiv do të jetë katër vjet, përveç rastit kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Palëve.

c) Asambleja e Palëve mund ta largojë Sekretarin Ekzekutiv me arsye, para përfundimit të mandatit të tij.

d) Sekretari Ekzekutiv do të jetë përfaqësuesi ligjor i EUTELSAT-it. Sekretari Ekzekutiv do të veprojë nën drejtimin e Asamblesë së Palëve dhe do të jetë drejtpërdrejt përgjegjës para tij, për përmbushjen e të gjitha funksioneve të Sekretariatit.

e) Sekretari Ekzekutiv do të ketë fuqinë të emërojë të gjithë stafin e Sekretariatit në bazë të miratimit të Asamblesë bazuar në nenin IX/"k".

f) Gjatë çdo vendi të lirë në postin e Sekretarit Ekzekutiv ose, kur Sekretari Ekzekutiv mungon ose është i paaftë të kryejë detyrat e tij, Sekretari Ekzekutiv në detyrë, i caktuar sipas

rregullave nga Asambleja e Palëve, do të ketë fuqinë për të ushtruar kompetencat e Sekretarit Ekzekutiv bazuar në Konventë.

g) Sekretari Ekzekutiv dhe stafi i Sekretariatit do të shmangin çdo veprim të papajtueshëm me përgjegjësitë e tyre në EUTELSAT.

Neni XI

Të drejtat dhe detyrimet

a) Palët do të ushtrojnë të drejtat dhe do të përmbushin detyrimet e tyre sipas Konventës, në përputhje të plotë me dhe në vijim të parimeve dhe dispozitave të Konventës.

b) Të gjitha Palët mund të marrin pjesë në të gjitha konferencat dhe mbledhjet në të cilat ata kanë të drejte të përfaqësohen, sipas parashikimeve në Konventë dhe në çdo mbledhje tjetër të thirrur ose të mbajtura nën kujdesin e EUTELSAT-it, në përputhje me marrëveshjen e bërë nga ai për takime të tilla, pavarësisht nga vendi se ku ata mund të zhvillohen.

c) Përpara se një konferencë ose mbledhje e tillë të zhvillohet jashtë vendit në të cilin është vendosur selia e EUTELSAT-it, Sekretari Ekzekutiv do të garantojë që marrëveshjet me Palën pritëse të këtyre takimeve dhe konferencave përfshijnë një dispozitë që rregullon hyrjen dhe qëndrimin në vendin organizues gjatë konferencës apo takimit nga përfaqësuesit e të gjitha Palëve që kanë të drejtë të marrin pjesë.

Neni XII

Selia EUTELSAT, privilegjet, imunitetet, përjashtimet

a) Selia e EUTELSAT do të jetë në Francë.

b) Brenda fushës së aktivitetit të autorizuar nga Konventa, EUTELSAT dhe prona e saj, në territorin e të gjitha Palëve, do të përjashtohet nga tatimet e drejtpërdrejta mbi pasuritë dhe të ardhurat dhe nga detyrimet doganore.

c) Çdo Palë do të njohë, në përputhje me Protokollin e përmendur në këtë paragraf, privilegjet e duhura, përjashtimet dhe imunitetet EUTELSAT, zyrtarëve të tij, dhe për atë kategori të punonjësve të saj të specifikuara në Protokoll, te Palët dhe përfaqësuesit e Palëve, dhe të personave që marrin pjesë në procedurën e arbitrazhit. Në veçanti, secila Palë duhet t'u njohë këtyre individëve imunitet nga ndjekja ligjore, në lidhje me veprimet e kryera ose fjalët e shkruara apo të shqiptuara në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe brenda kufijve të detyrave të tyre, në masën dhe në raste të parashikuara në Protokollin e përmendur në këtë paragraf. Pala, në territorin e së cilës është e vendosur Selia e EUTELSAT-it, duhet, sa më shpejt të jetë e mundur, të hartojë ose, sipas rastit, të rihartojë me EUTELSAT-in , një protokoll që përfshin privilegjet, përjashtimet dhe imunitetet. Palët e tjera gjithashtu, sa më shpejt që të jetë e mundur, të hartojnë një Protokoll, që përfshin privilegje, përjashtimet dhe imunitetet. Marrëveshja për selinë qendrore dhe Protokolli do të përshkruajë për secilin kushtet e përfundimit të tij dhe do të jetë i pavarur nga Konventa.

Neni XIII

Tërheqja

a) Çdo Palë mund të tërhiqet vullnetarisht nga EUTELSAT-i në çdo kohë me anë të njoftimit me shkrim te depozitari, siç përcaktohet në nenin XXI. Një tërheqje e tillë do të ketë efekt tre muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga depozitari.

b) Nëse një Palë ka dështuar të pajtohet me ndonjë detyrim sipas Konventës, Asambleja e Palëve, pasi ka marrë njoftim për këtë rezultat ose duke vepruar me iniciativën e saj dhe duke konsideruar çdo përfaqësim të bërë nga Palët, mund të vendosë, nëse konstaton se dështimi për t'u pajtuar ka ndodhur, që Pala të konsiderohet se është tërhequr nga EUTELSAT-i dhe, nga

data e një vendimi të tillë, Konventa do të pushojë së qenëri në fuqi për atë Palë. Një mbledhje e jashtëzakonshme e Asamblesë së Palëve mund të thirret për këtë qëllim.

c) Një Palë e cila është tërhequr ose mendohet të jetë tërhequr nga EUTELSAT-i do pushojë të ketë të drejtën e përfaqësimit në Asamblenë e Palëve dhe nuk do të ketë asnjë pasojë ose detyrim apo përgjegjësi pas datës efektive të tërheqjes, përveç detyrimeve që rrjedhin nga veprimet ose mosveprimet para asaj date.

d) Çdo njoftim i tërheqjes dhe çdo vendim që ndikon në tërheqjen e konsideruar do t'u komunikohet menjëherë të gjitha Palëve nga depozitari.

Neni XIV
Ndryshimet dhe ndërprerja

a) Amendamentet e kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo Palë dhe duhet t'i komunikohen Sekretarit Ekzekutiv, i cili menjëherë do t'i qarkullojë propozimet te të gjitha Palët. Asambleja e Palëve do të shqyrtojë amendamentin e propozuar jo më parë se gjashtë muaj nga qarkullimi i saj, duke marrë parasysh çdo rekomandim të bërë nga Kompania Eutelsat S.A., pikëpamjet e së cilës duhet të kërkohen në qoftë se propozimi për amendim i Konventës, është i detyruar të ndikojë në performancën e aktiviteteve të saj. Kjo periudhë mund, në ndonjë rast të veçantë, të reduktohet nga Asambleja e Palëve, me një vendim të marrë në përputhje me procedurën për një çështje thelbësore.

b) Nëse miratohet nga Asambleja e Palëve, amendimet do të hyjnë në fuqi njëqind e njëzet ditë, pasi Depozituesi ka marrë njoftimet e pranimit nga dy të tretat e këtyre shteteve, të cilat, në kohën e miratimit nga Asambleja e Palëve, ishin Palë. Me hyrjen e saj në fuqi, amendimet do të bëhen të detyrueshme për të gjitha Palët.

c) Palët mund të çojnë EUTELSAT-in në fundin e tij, me përfundimin e Konventës me dy të tretat e shumicës së të gjitha Palëve.

d) Përfundimi i kësaj Konvente nuk do të ndikojë në vazhdimin e ekzistencës së Kompanisë Eutelsat S.A.

d) Nëse nuk është rënë dakord ndryshe me Kompaninë Eutelsat S.A., asnjë vendim për përfundimin e EUTELSAT-it, bazuar në paragrafin "c" të këtij neni, nuk do të merret për aq kohë, sa të drejtat ndërkombëtare dhe detyrimet e përmendura në paragrafin "b", të nenit III nuk janë shuar tërësisht.

Neni XV
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet Palëve ose ndërmjet EUTELSAT dhe një pale, ose disa Palëve, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Konventës, do t'i dorëzohen arbitrimit, në përputhje me shtojcën B të Konventës, në qoftë se, nuk zgjidhet ndryshe brenda një viti nga koha që njëra Palë në mosmarrëveshje ka njoftuar Palën tjetër për qëllimin e saj, për të zgjidhur këtë mosmarrëveshje, miqësisht nëpërmjet arbitrazhit.

b) Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin, në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Konventës ndërmjet një Pale dhe një shteti që ka pushuar së qenëri Palë ose ndërmjet EUTELSAT dhe një shteti, i cili ka pushuar së qenëri Palë, dhe këto mosmarrëveshje kanë lindur pasi shteti ka pushuar së qenëri Palë, do të dorëzohen në arbitrazh, në përputhje me dispozitat e shtojcës B të Konventës, nëse nuk zgjidhet ndryshe brenda një viti që njëra Palë në mosmarrëveshje ka njoftuar Palën tjetër për qëllimin e saj, për të zgjidhur këtë mosmarrëveshje në mënyrë miqësore, me kusht që shteti i cili ka pushuar së qenëri Palë në këtë mënyrë bie dakord. Nëse një shtet pushon së qenëri Palë, nëse janë pjesë e një mosmarrëveshjeje e cila është paraqitur në arbitrazh, sipas paragrafit "a" të këtij neni, arbitrazhi do të vazhdojë dhe do të mbyllet.

Neni XVI

Nënshkrimi – Rezervimet

a) Çdo shtet, administrata e telekomunikacioneve e të cilit ose Agjencia e Njohur Operuese Private në këtë fushë është ose ka të drejtë për t'u bërë një Palë nënshkruese e Marrëveshjes së Përkohshme, mund të bëhet Palë në Konventë nëpërmjet:

i. nënshkrimit që nuk u nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit; ose

ii. nënshkrimit që u nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

iii. aderimit.

b) Konventa do të jetë e hapur për nënshkrim në Paris nga 15 korriku 1982 deri në hyrjen në fuqi dhe pas kësaj mbetet e hapur për aderim.

c) Asnjë rezervë nuk mund t'i bëhet kësaj Konvente.

Neni XVII

Hyrja në fuqi

a) Konventa do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës në të cilën ajo është firmosur, në përputhje me nënparagrafin "i", të paragrafit "a", të nenit XVI të Konventës ose, kur është ratifikuar, pranuar ose miratuar, nga dy të tretat e shteteve, të cilat, në datën në të cilën ajo është e hapur për nënshkrim, kanë juridiksion mbi Palët nënshkruese të Marrëveshjes së Përkohshme, me kusht që këto Palë Nënshkruese ose nënshkruesit e caktuar të tyre të Marrëveshjes ECS, të mbajnë të paktën dy të tretat e aksioneve financiare nën Marrëveshjen ECS.

b) Konventa nuk do të hyjë në fuqi në më pak se tetë muaj pas datës në të cilën ajo është e hapur për nënshkrim. Konventa nuk do të hyjë në fuqi në qoftë se ajo nuk ka qenë e nënshkruar, ratifikuar, pranuar ose miratuar, sipas paragrafit "a" të këtij neni, brenda tridhjetë e gjashtë muajsh nga data në të cilën ajo është e hapur për nënshkrim.

c) Për një shtet, instrumenti i ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit të të cilit është depozituar pas datës në të cilën Konventa hyn në fuqi, Konventa do të të hyjë në fuqi në datën e depozitimit të tillë.

d) Me hyrjen në fuqi, Konventa do të zbatohet përkohësisht për çdo shtet i cili e ka kushtëzuar nënshkrimin me ratifikimin, pranimin ose miratimin dhe ka kërkuar këtë gjë, në kohën e nënshkrimit ose në çdo kohë të mëvonshme para hyrjes në fuqi. Zbatimi i përkohshëm do të përfundojë:

i. me depozitimin e instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit nga ana e atij shteti; ose

ii. në fund të dy viteve nga data në të cilën Konventa hyn në fuqi pa u ratifikuar, pranuar ose miratuar nga shteti; ose

iii. pas njoftimit nga ana e atij shteti, para përfundimit të periudhës së përmendur në nënparagrafin "ii" të këtij paragrafi, për vendimin e saj për të mos ratifikuar, pranuar ose miratuar Konventën.

Kur aplikimi i përkohshëm përfundon sipas nënparagrafit "ii" ose "iii" të këtij paragrafi, paragrafi "c", të nenit XIII të Konventës do të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e Palës.

e) Me hyrjen në fuqi, Konventa do të zëvendësojë dhe do të përfundojë Marrëveshjen e Përkohshme. Megjithatë, asgjë në këtë Konventë nuk do të prekë ndonjë të drejtë apo detyrim të Palës së fituar në kapacitetin e saj të mëparshëm si një Palë nënshkruese e Marrëveshjes së Përkohshme.

Neni XVIII

Aderimi

a) Çdo shtet, administrata e telekomunikacioneve e të cilit ose agjencia e njohur operuese private ka qenë ose kishte të drejtën të bëhej, një Palë nënshkruese e Marrëveshjes së

Përkohshme, në datën në të cilën Konventa është e hapur për nënshkrim, mund të aderojë në Konventë nga data në të cilën ajo pushon së qenëri e hapur për nënshkrim, deri në dy vjet pas hyrjes së saj në fuqi.

b) Dispozitat e paragrafëve "c", "e" të këtij neni do të zbatohen për kërkesat për anëtarësim nga shtetet e mëposhtme:

i. një shtet, administrata e telekomunikacioneve e të cilit ose Agjencia e njohur operuese private e fushës ishte ose kishte të drejtën për t'u bërë, një Palë nënshkruese e Marrëveshjes së Përkohshme, në datën në të cilën Konventa u hap për nënshkrim, i cili nuk është bërë Palë e Konventës në përputhje me nënparagrafët "i" ose "ii", të paragrafit "a", të nenit XVI të Konventës, ose paragrafin "a" të këtij neni;

ii. çdo shtet tjetër evropian i cili është anëtar i Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit që dëshiron të aderojë në Konventë pas hyrjes së saj në fuqi.

c) Çdo shtet që dëshiron të aderojë në Konventë në rrethanat e përmendura në paragrafin "a" të këtij neni (shteti kërkues) do të njoftojë Sekretarin Ekzekutiv me shkrim dhe do t'i paraqesë Sekretariatit të gjitha informacionin përkatës për kërkesën.

d) Sekretari Ekzekutiv do të marrë aplikimin e shtetit kërkues dhe ia paraqet atë Asamblesë së Palëve.

e) Asambleja e Palëve do të marrë një vendim për kërkesën e shtetit kërkues brenda gjashtë muajve pas datës në të cilën Sekretari Ekzekutiv vendos që ai ose ajo ka plotësuar të gjithë informacionin e kërkuar sipas paragrafit "c" të këtij neni. Vendimi i Sekretarit Ekzekutiv do t'i njoftohet menjëherë Asamblesë së Palëve. Vendimi i Asamblesë së Palëve do të merret me votim të fshehtë dhe në përputhje me procedurat për vendimet mbi çështjet thelbësore. Asambleja e Palëve mund të mblidhet në mënyrë të jashtëzakonshme për këtë qëllim.

f) Sekretari Ekzekutiv do të njoftojë shtetin kërkues për kushtet për aderim të vendosura nga Asambleja e Palëve, të cilat do të jetë pjesë e një protokolli që i bashkëngjitet instrumentit të pranimit të depozituar nga ky shtet pranë depozitarit.

Neni XIX
Përgjegjësia

Asnjë Palë nuk do të jetë individualisht përgjegjëse për veprimet dhe detyrimet e EUTELSAT-it, me përjashtim kur të tilla përgjegjësi, rezultojnë nga një traktat, në të cilën Pala dhe një shtet që kërkon kompensim janë Palë. Në këtë rast, EUTELSAT-i do të dëmshpërblejë Palën e interesuar, duke respektuar çdo detyrim, me përjashtim, kur ky i fundit ka marrë përsipër shprehimisht që do të jetë përgjegjës në mënyrë ekskluzive.

Neni XX
Dispozita të ndryshme

a) Gjuhët zyrtare dhe të punës së EUTELSAT-it do të jenë anglishtja dhe frëngjishtja.

b) EUTELSAT-i duhet, që duke pasur parasysh pikëpamjet e përgjithshme të Asamblesë së Palëve, të bashkëpunojnë mbi çështjet e interesit të përbashkët me Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e specializuara të saj, në veçanti Bashkimin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, si dhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

c) Në përputhje me Rezolutën 1721 (XVI) të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, EUTELSAT-i do t'i dërgojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, dhe agjencive të specializuara të interesuara, për informacionin e tyre, një raport vjetor mbi aktivitetet e saj. Raporti vjetor duhet, gjithashtu, t'i dërgohet Kompanisë Eutelsat S.A.

Neni XXI
Depozitari

a) Qeveria e Republikës Franceze do të jetë depozitari i kësaj Konvente, me të cilën do të depozitohen instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, kërkesat për aplikim të përkohshëm dhe njoftimet e ratifikimit, pranimit ose miratimit të amendimeve dhe të vendimit të tërheqjes nga EUTELSAT-i, ose përfundimit të zbatimit të përkohshëm të Konventës.

b) Konventa do të depozitohet në arkivat e depozitarit. Depozitari do të dërgojë kopje të njësuar/certifikuar të tekstit të Konventës për të gjitha shtetet që e kanë nënshkruar atë apo që kanë depozituar instrumentet e aderimit në të dhe te Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit.

c) Depozitari duhet menjëherë të informojë të gjitha shtetet që kanë nënshkruar apo aderuar në Konventë dhe, nëse është e nevojshme, Bashkimin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, për:

i. të gjitha nënshkrimet e Konventës;

ii. depozitimin e të gjitha instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;

iii. fillimin e periudhës gjashtëdhjetëditore, referuar në paragrafin "a", të nenit XVII të Konventës;

iv. hyrjen në fuqi të Konventës;

v. të gjitha kërkesat për aplikim të përkohshme sipas paragrafit "d", të nenit XVII të Konventës;

vi. emërimin e Sekretarit Ekzekutiv, sipas paragrafit "a" të nenit X të Konventës;

vii. miratimin dhe hyrjen në fuqi e të gjitha amendimeve të Konventës;

viii. të gjitha njoftimet për tërheqje;

ix. të gjitha vendimet e Asamblesë së Palëve, sipas paragrafit "b", të nenit XIII të Konventës që një Palë konsiderohet se është tërhequr nga EUTELSAT-i;

x. të gjitha njoftimet dhe komunikimet tjera rreth Konventës.

d) Me hyrjen në fuqi të Konventës, depozitari duhet t'i dërgojë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, për regjistrim dhe publikim në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kopje të konfirmuar të njësuar të kësaj Konvente.

Dëshmuar nga nënshkruesit e autorizuar nga qeveritë respektive, kanë nënshkruar këtë Konventë 1(*).

E hapur për nënshkrim në Paris, në ditën e pesëmbëdhjetë të korrikut, njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy, në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, të dyja tekstet janë njëlloj autentike, në një origjinale të vetme.

SHTOJCA A

Dispozita kalimtare

1. Vazhdimësia e aktiviteteve

a) Çdo marrëveshje nënshkruar nga EUTELSAT-i, e cila është në fuqi në kohën kur Kompania Eutelsat S.A. është themeluar, do të mbetet në fuqi, nëse dhe derisa të modifikohet ose përfundojë, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje. Çdo vendim i marrë nga EUTELSAT-i i cili është në fuqi në kohën kur Kompania Eutelsat S.A. është themeluar do të mbetet në fuqi nëse dhe derisa ky vendim të modifikohet ose përfundojë.

b) Në qoftë se, në kohën kur Kompania Eutelsat S.A. është themeluar, çdo organ i EUTELSAT-it ka nisur, por nuk ka përfunduar, çdo veprim, i cili është i autorizuar apo i nevojshëm për t'u marrë, Sekretari Ekzekutiv apo Drejtori Ekzekutiv (CEO) i parë i kompanisë Eutelsat S.A., brenda kompetencave të tyre përkatëse dhe në përputhje me marrëveshjet e bëra

[1] *Shtetet anëtare të EUTELSAT-it: Austria, Belgjika, Qipro, Danimarka, Finlanda, Franca, [Gjermani (Fed. Rep)], Greqi, Islandë, Irlandë, Itali, Lihtenshtajni, Luksemburgu, Malta, Monako, Hollanda, Norvegjia, Portugalia, San Marino, Spanja, Suedia, Zvicra,Turqia, Mbretëria e Bashkuar, Vatikani, Jugosllavia.*

ndërmjet EUTELSAT-it dhe kompanisë Eutelsat S.A., do të zëvendësojë atë organ me qëllim përfundimin e një aktiviteti të tillë.

2. Mënyra e transferimit

a) EUTELSAT-i do të hyjë në një marrëveshje transferimi (Marrëveshja e Transferimit) me Kompaninë Eutelsat S.A., për të transferuar çdo aset ose të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj në lidhje me aktivitetin e saj (plotësisht, të përcaktuar nga Marrëveshja e Transferimit) te Kompania Eutelsat S.A. (Transferimi).

b) Transferimi do të rezultojë në një transferim universal të të gjitha të drejtave, titujt, interesat dhe përfitimet mbi to, gjithashtu, dhe të gjitha detyrimeve dhe përgjegjësive bashkëngjitur, asetet dhe përgjegjësitë e transferuara do të përbëjë një filial të plotë dhe autonom të aktivitetit. Një transferim i tillë do të ketë të njëjtat efekte si një *spin-off* (ndarje) transferim aktiviteti, parashikuar në nenin 382 në vijim, të ligjit francez, N° 66–537, të 24 korrikut, 1966, në lidhje me shoqëritë tregtare, me përjashtim që asnjë nga detyrimet dhe formalitetet normalisht të detyrueshme mbi transferuesin (shoqërinë transferuese), sipas ligjit, do të jenë të zbatueshme për EUTELSAT-in.

c) Në veçanti dhe pa paragjykime për sa më sipër, transferimi do të ketë efekte *erga omnes* (ndaj të gjithëve) që nga data e përcaktuar në Marrëveshjen e Transferimit pa i kërkuar njoftim, pëlqim apo miratim, çdo personi, duke përfshirë çdo personi ndaj të cilit, çdo detyrim dhe përgjegjësi e tillë, i detyrohet. Transferimi do të ketë efekte në të njëjtën mënyrë, në lidhje me çdo person, me të cilin EUTELSAT-i, ka lidhur një marrëveshje të një natyre *intuitu personae*.

3. Menaxhimi

a) Bazuar në pikën 2/"c" më sipër, i gjithë personeli i organit ekzekutiv të EUTELSAT-it do të ketë drejtën për t'u transferuar në Kompaninë Eutelsat S.A., si dhe personat që e ushtrojnë këtë të drejtë në datën e transferimit të tyre do të gëzojnë termat dhe kushtet e punësimit që janë, për aq sa ato janë në përputhje me ligjin francez, të paktën të barasvlershme me ato që ata gëzonin menjëherë para datës së transferimit të tyre.

b) Në lidhje me personat të cilët, në datën e transferimit, janë në marrjen e përfitimeve sipas rregullave të Skemës së Pensioneve të EUTELSAT-it, këto përfitime do të vazhdojnë të paguhen, në përputhje me të gjitha dispozitat përkatëse, të këtyre rregullave, të cilat ishin në fuqi, si në datën e transferimit.

c) Në lidhje me personat të cilët, në datën e transferimit, kanë fituar të drejta për të marrë përfitimet, sipas rregullave të Skemës së Pensioneve të EUTELSAT-it, do të bëhen rregullimet e duhura në mënyrë që t'u ruhen këto të drejta.

d) Në përputhje me paragrafin 1 të kësaj shtojce, kushtet e punësimit të personelit në fuqi, do të vazhdojnë të zbatohen deri sa kushtet e reja të punësimit do të hartohen nga Kompania Eutelsat S.A.

e) Deri sa Kryetari i parë i Drejtorisë së Kompanisë Eutelsat S.A., dhe Sekretari i Parë Ekzekutiv të marrin zyrtarisht detyrat, funksionet e tyre përkatëse do të kryhen nga Drejtori i Përgjithshëm i EUTELSAT-it.

4. Transferimi te Kompania Eutelsat S.A. dhe te Sekretari Ekzekutiv i funksioneve të EUTELSAT-it.

a) Në datën e themelimit të Kompanisë Eutelsat S.A. dhe të Sekretariatit, Drejtori i Përgjithshëm i EUTELSAT-it njofton të gjithë të interesuarit.

b) Drejtori i Përgjithshëm i EUTELSAT-it do të marrë të gjitha masat për një transferim në kohë te Kompania Eutelsat S.A. dhe Sekretari Ekzekutiv, të të gjitha të drejtave dhe të detyrimeve të fituara nga EUTELSAT-i, në cilësinë e tij si përfaqësues ligjor i EUTELSAT-it.

SHTOJCA B
Procedura e arbitrazhit

1. Për qëllime të gjykimit të çdo mosmarrëveshjeje referuar nenit XV të Konventës, do të krijohet një Gjykatë Arbitrazhi në lidhje me paragrafët në vijim.

2. Çdo Palë e Konventës mund t'i bashkohet secilës Palë në arbitrazh.

3. Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre anëtarë. Secila Palë në mosmarrëveshje do të emërojë një arbitër brenda një periudhe prej dy muajsh, llogaritur nga data e marrjes së kërkesës nga njëra Palë për të përcjellë mosmarrëveshjen në arbitrazh. Aty ku neni XV i Konventës kërkon marrëveshje të Palëve që të zgjidhin mosmarrëveshjet në arbitrazh, periudha prej dy muajsh, do të llogaritet nga data e kësaj marrëveshjeje. Dy arbitrat e parë, brenda një periudhe prej dy muajsh, llogaritur nga caktimi i arbitrit të dytë, emërojnë arbitrin e tretë, i cili do të jetë Kryetari i Gjykatës se Arbitrazhit. Nëse një prej dy arbitruesve nuk ka qenë i caktuar brenda periudhës së kërkuar, me kërkesë të secilës Palë, ai do të emërohet nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ose, nëse nuk ka marrëveshje ndërmjet Palëve, Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit. E njëjta procedurë do të zbatohet në qoftë se kryetari i Gjykatës së Arbitrazhit nuk ka qenë i nominuar brenda periudhës së kërkuar.

4. Gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë selinë e saj dhe do të vendosë rregullat e veta të procedurës.

5. Secila Palë do të mbartë koston, në lidhje me arbitrin, për nominimin e të cilit ai është përgjegjës, si dhe kostot e të qenërit i përfaqësuar para gjykatës. Shpenzimet në lidhje me kryetarin e Gjykatës së Arbitrazhit do të ndahen në mënyrë të barabartë nga Palët në mosmarrëveshje.

6. Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit do të merret me shumicën e anëtarëve të tij, të cilët nuk mund të abstenojnë nga votimi. Ky vendim do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të gjitha Palët në mosmarrëveshje dhe asnjë ankesë nuk do të ekzistojë kundër tij. Palët do të pajtohen me vendimin pa vonesë. Në rastin e një mosmarrëveshjeje sipas kuptimit të saj apo qëllimit, Gjykata e Arbitrazhit do ta interpretojë atë me kërkesë të çdo pale në mosmarrëveshje.